



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1339_06_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **10.07.2015**

në seancën e mbajtur më datë 16 korrik 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh.G. (parashtruesi i ankesës D.N.), me shifër DGJ- 1508 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1339_06_15** i datës 03.06.2015.

A r s y e t i m

Me datë 25.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 2989472, ku gjendja e kilovatorëve në tarifën e lartë është TL=47135 kWh dhe në tarifën e ulët është TU=40909 kWh, dhe është konstatuar se njehsori elektrik duhet të shkoj në kalibrim për verifikim pasi që numërori është i bllokuar.

Konsumatori me datë 05.03.2010 ka parashtruar kërkesë në KEK për ndërrimin e njehsorit elektrik, pasi që dyshon në matje jo të saktë.

Me datë 10.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 2989472 me gjendje TL=47135 kWh dhe TU=40909 kWh, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 07778728 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, ku edhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është i bllokuar.

Pas kësaj, Departamenti i faturimit në KEDS me datë 29.05.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën maj 2014 me kilovatorë të shpenzuar në tarifën e lartë **TL=10427 kWh** si dhe në tarifën e ulët **TU=2078 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare prej **952.56€**. Pas marrjes së faturës për muajin maj 2014 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS me të cilën ka kundërshtuar faturimin e muajit e këtij muaji me arsyetimin se vlera e faturuar i është e pabazë duke marr shpenzimin real që kam për çdo muaj.



Me datë 30.07.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e **aprovuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke bërë korrigjimin në vlerë financiare prej -339.84€, duke u bazuar në faturimin e muajit 05/2014 dhe muajve paraprak deri në periudhën 03/2010, ku është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik.

I pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it dhe korrigjimin e bërë konsumatori gjatë muajit 08.2014 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së, me të cilën ka kërkuar që të shqyrtohet edhe njëherë fatura e muajit maj 2014, pasi që vlera e saj kap shumë prej 952.56€, si dhe faturat tjera të energjisë elektrike pasi që sipas konstatimeve të tij i njëjti dyshon se KEDS e ka dëmtuar edhe në fatura tjera për shkak të leximit jo të rregullt të njehsorit elektrik.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që ta abrogoi vendimin e **ZRRE/DMK_V_1339_06_15** i datës 03.06.2015 dhe të pranoj si të bazuar ankesën e konsumatorit Shaban Gashi parashtruesit Durim Nuza. Pikat që konsumatori ka atakuar në ankesë është se i njëjti nuk pajtohet me konstatimin e KEK se njehsori elektrik është i bllokuar pasi që sipas tij njehsori elektrik është ende në rregull. Pika e dytë e kundërshtimit është se konsumatori nuk pajtohet me arsyetimin e vendimit të DMK-së se i njëjti ka bërë kërkesë për ndërrimin e njehsorit elektrik, pasi që sipas tij i njëjti nuk ka bërë asnjë kërkesë për ndërrim njehsori. Në pikën 3 konsumatori i konteston thëniet në vendimin e DMK se KEDS ka vepruar në përputhje me kërkesën e konsumatorit për ndërrim njehsori pasi që sipas tij i njëjti nuk ka bërë një kërkesë të tillë pasi që njehsori ka qenë në rregull. Pika 4 e kundërshtimit të ankesës është se i njëjti nuk pajtohet se KEDS ka dorëzuar faturën e muajit 05/2014 për shpenzim të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 korrik 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Lidhur me pikën e parë të kundërshtimit nga ana e konsumatorit i cili nuk pajtohet me konstatimet e KEK e të theksuara në vendimin e DMK-së se njehsori elektrik është i bllokuar pasi që sipas tij njehsori elektrik është ende në rregull. Bordi i ZRRE-së ka analizuar këtë pikë kontestuese dhe ka vërtetuar se një konstatim i tillë është i theksuar në procesverbalet e përpiluar nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEDS si, procesi nr. 127047 i datës 25.02.2010, si dhe procesi nr. 010431 i datës 10.03.2010, andaj sipas Bordit një konstatim i tillë i theksuar në ankesë nga ana e konsumatorit është i pabazë dhe i paargumentuar me prova.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të pikës së dytë ku konsumatori thekson se nuk ka bërë kërkesë për ndërrim njehsori, ka konstatuar se në shkresat e lëndës gjendet aplikacioni në të cilën janë të paraqitura të gjitha të dhënat rreth njehsorit elektrik dhe nga kjo kërkesë vërtetohet se KEDS, ka bërë edhe ndërrimin e njehsorit elektrik. Bordi gjithashtu konstaton se ndërmarrja e energjisë elektrike ka të drejtë ligjore që sa herë që dyshon në gjendjen teknike të njehsorit elektrik mund të ndërhyjë në të dhe në ndërrimin e tij edhe pa kërkesën e konsumatorit.

Pika tjetër e kundërshtimit se nuk qëndrojnë argumentet si në vendimin e DMK-së se konsumatori i është bërë një faturë në vlerë financiare prej 952.56€ për muajin 05/2014. Edhe për këtë pikë kontestuese Bordi ka analizuar transaksionet e konsumatorit me ç'rast ka gjet se qëndrojnë thëniet si në vendimin e shkallës së parë se konsumatori është faturuar me një grumbullim të kilovatorëve dhe për më tepër një faturë dhe vlerë të tillë financiare e ka kundërshtuar me ankesë edhe vetë konsumatori, andaj si mund të thuhet se nuk ekziston një faturë e tillë. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se KEDS-i ka bërë korrigjimin në vlerë prej -339.84 € e cila ka përfshi periudhën nga 03/2010 deri në



periudhen 05/2014 pasi që gjatë kësaj periuedhe KEDS-i nuk ka bërë lexim të saktë të pikës matëse dhe korrjimi i tillë është i saktë dhe se kjo është theksuar edhe në vendimin e shkallës së parë të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2015 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1339_06_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar